



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.275, datë 01.07.2021

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË
NË GJYKATËN E LARTË, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 01.07.2021 pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...},

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1. Me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

2. Me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

3. Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

4. Afati i kandidimit për të tria procedurat e ngritjes në detyrë sipas vendimeve si më lart të Këshillit, është përcaktuar dy javë për Vendimet nr. 85 dhe nr. 86 ku për shkak të situatës së krijuar

nga përhapja e Covid-19, afatet e kandidimit u pezulluan¹ dhe më pas u zgjatën² për të dyja procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të hapura me vendimet e sipërcituara. Ndërsa për Vendimin nr. 87 datë 26.02.2020 afati i kandidimit është përcaktuar pesë muaj deri më datë 30.07.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionet e lira si më lart në fushën e të drejtës civile, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizua.

II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

6. Pas përfundimit të afatit të kandidimeve edhe për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në fushën e të drejtës civile, me Vendimet nr. 151, datë 06.05.2020 vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, ndër ta edhe për znj. {...}, për të cilin, pas zhvillimit të shortit, caktoi si relator z. Alban Toro. Gjithashtu, me Vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për znj. {...}, duke përcaktuar për kandidaten se procedura e filluar me Vendimin e tij nr. 151, datë 06.05.2020, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020.

7. Më datë 12.05.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.05.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}.

¹ Më datë 12.03.2020.

² Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020.

10. Bazuar në Vendimin 75/2019 të Këshillit si dhe pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatës në lidhje me tre kriteret formale³ të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira të shpallura me këto vendimi, që të dyja në fushën e të drejtës civile. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 235, datë 02.07.2020, Këshilli vendosi:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020...”.

11. Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.87, datë 26.02.2020, anëtari i Këshillit, z.Alban Toro, i caktuar më herët si relator në procedurën e verifikimit ndaj kandidatës znj. {...}, ka hequr dorë. Pas shortit të hedhur, me Vendimin nr.352, datë 24.09.2020, Këshilli vendosi të caktoj si relator në procedurën e verifikimit ndaj kandidatës {...}, anëtarin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z.Ilir Toska. Po më datë 24.09.2020, kandidatja u njoftua në adresën e saj zyrtare elektronike për zëvendësimin e relatorit të procedurës së verifikimit ndaj saj. Brenda afatit të caktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorit të caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

12. Bazuar në Vendimin 75/2019 të Këshillit si dhe pikën 9, të Vendimit të tij nr. 87, datë 26.02.2020, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatës në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me këtë vendim, në fushën e të drejtës civile. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 388, datë 07.10.2020, Këshilli vendosi:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj.{...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

³ Tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020...”.

13. Vlen të përmendet se, me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, kjo me qëllim për bërjen e kësaj të fundit funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së renditjes dhe ngritjes në detyrë të kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

14. Paralelisht me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për kandidaten, ka vijuar edhe procedura e verifikimit në lidhje me kriteret e pasurisë dhe të figurës.

15. Sa i përket verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe të figurës, në nenin 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.* Ndërkohë, në shkronjën “b”, pika 5, të Vendimeve të Këshillit nr.85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë pranë Gjykatës së Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: ... b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.* Në Vendimin 75/2019, pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. Kështu, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, përcaktohet se: *“1.*

Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, do t'i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar”.

16. Gjatë verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe të figurës, u konstatua se kandidatja znj. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 167, datë 21.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë më datë 07.08.2019, pa u ankimuar. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidate u shtri për periudhën pas datës 07.08.2019 që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e saj në detyrë.

17. Në përfundim të verifikimit edhe për kriteret e pasurisë dhe figurës, me Vendimin nr. 447 date 14.10.2020, Këshilli vendosi:

- 1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.*
- 2. Vendimet nr. 235, datë 02.07.2020 dhe nr. 388, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.*

18. Ndërkohë, në zbatim të pikës 5, të nenit 171, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në Programin e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020, Këshilli, me Vendimin nr.198, datë 11.06.2020, vendosi:

- “I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional.*

II. *Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë: ...; Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili; ...*”.

19. Ndërsa, mbas vendimit sipas pikës 14, Këshilli, me vendimin nr. 247, datë 09.07.2020, vendosi:

“I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.

II. *Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë: ... 7. Për gjyqtaren znj. {...}- Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku⁴. ...*”.

20. Ndërkohë, pas përfundimit të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për kandidatën, Këshilli, me Vendimin nr.146, datë 08.04.2021, vendosi:

“1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. *Aftësitë profesionale - “Shkëlqyeshëm”;*
- B. *Aftësitë organizative - “Shkëlqyeshëm”;*
- C. *Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale - “Shkëlqyeshëm”;*
- D. *Aftësitë personale dhe angazhimi profesional - “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit - “Shkëlqyeshëm”. ...*”.

21. Ndërsa, pas përfundimit të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019 për kandidatën, Këshilli, me Vendimin nr.147, datë 08.04.2021, vendosi:

“1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. *Aftësitë profesionale - “Shkëlqyeshëm”;*
- B. *Aftësitë organizative - “Shkëlqyeshëm”;*
- C. *Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale - “Shkëlqyeshëm”;*
- D. *Aftësitë personale dhe angazhimi profesional - “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit - “Shkëlqyeshëm”. ...*”.

22. Më herët, në kushtet kur për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, përfshirë edhe ato të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, kishte kandidatë të kualifikuar, bazuar në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

⁴ Për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit për z. Fatbardh Çoniku, nëpunës përgjegjës për vlerësimin është caktuar znj. Zeta Tërpollari, me Vendimin e Këshillit nr. 522, datë 27.10.2020.

në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, me qëllim përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli, me Vendimin nr. 55, datë 16.02.2021, ndër të tjera, vendosi:

“1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, edhe për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për emërim sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë: ...; c) Për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile - relator z. Alban Toro ...”.

23. Më datë 17.02.2021, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatja u njoftua për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundështime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMET

24. Ndërsa procedura e përzgjedhjes për emërim vijonte, me Shkresën e datës 02.06.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2361/1 prot., datë 02.06.2021, kandidatja ka paraqitur një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të ka parashtruar: *“Nëpërmjet kësaj kërkesë, duke qenë se nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë-në fushën e të drejtës civile-, shpreh vullnetin tim me shkrim të tërheqjes nga kandidimi, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87 datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kërkesa ime bazohet në seksionin e V “ Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes për ngritje në detyrë” të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” Dhe, meqenëse nga normuesi nuk kërkohet të jepen arsyet e tërheqjes nga kandidimi mjaftohem duke depozituar kërkesën me shkrim (tërheqje nga kandidimi për në Gjykatën e Lartë) me lutjen që të merrni në konsiderat këtë kërkesë duke vendosur sipas pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit nr.70, datë 07.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.*

25. Në rrethanat sa sipër, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti relacionin përkatës, bazuar në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes,*

Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. ...”.

26. Në Mbledhjen e datës 08.06.2021 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të rregullt procedurat e ndjekura për kandidaten znj. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimet për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e këtyre procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI I KËRKESËS SË KANDIDATES DHE VLERËSIMI I SAJ

27. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 136, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se: *“1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi... 3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”*, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

28. Këshilli në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrën në Gjykatën e Lartë edhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, duke u mbështetur në një sërë ligjesh, midis tyre dhe në Kodin e Procedurave Administrative, miratuar me Ligjin 44/2015. Ky Kod përcakton se procedura administrative për kandidatin përkatës inicohet me kërkesën për shprehje të interesit nga ana e kandidatit për t’u bërë pjesë e një procedure të caktuar, e cila finalizohet me një vendim në favor ose jo të kandidatit. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga ana e organit kompetent, Këshillit, dhe për rrjedhojë, procedura e inicuar për atë kandidat mund të përfundohet pa një vendim përfundimtar. Konkretisht, në nenin 64, pika 2 të Ligjit 44/2015 përcaktohet se: *“...2. Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”*. Po ashtu, në pikën 3, të nenit 90, përcaktohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative”*. Ndërsa në pikën 1, të nenit 94, përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron*

përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

29. Kjo e drejtë ligjore, në rastin e procedurës administrative që realizon Këshilli, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ka gjetur rregullim specifik në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. ...”.*

30. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja znj. {...}, brenda afatit të kandidimit, ka paraqitur kërkesë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurave të përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, për këto pozicione të lira, ndërsa rezulton që këto procedura të mos kenë përfunduar ende, kandidatja u tërhoq nga kandidimi, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në letër, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t’u tërhequr nga kandidimet.

V. KONKLUZIONE

31. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja znj. {...}, ka shprehur sipas ligjit, vullnetin e saj të qartë dhe të plotë për t’u tërhequr nga kandidimi në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, prandaj Këshilli është para rastit për të vendosur përfundimin e e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, në pikën 3, të nenit 90 dhe në pikën 1, të nenit 94, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 61 dhe në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR